

Znj. Joana Troqe ka mbaruar studimet e larta të nivelit “Master Shkencor” në University College London (UCL), në programin e studimit “Politika Publike Ndërkombëtare” si dhe studimet Bachelor dhe Master në Universitetin e New York-ut në Tiranë.

Prej vitit 2016, znj. Joana Troqe ka ushtruar detyrën e auditueses dhe përgjegjëses së grupit të auditimit në KLSH me fokus kryerjen e auditimeve financiare dhe të përputhshmërisë në kuadër të hartimit të Raportit të Zbatimit të Buxhetit të Shtetit.

Aktualisht është në pozicionin e “Drejtorit” të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

Përgjatë karrierës së saj në Kontrollin e Lartë të Shtetit është angazhuar në një sërë trajnimesh, konferencash, seminare, brenda dhe jashtë vendit në lidhje me çështje të auditimit të jashtëm në sektorin publik nga institucione të ndryshme apo SAI-e të tjera; si dhe e pajisur me certifikatën ndërkombëtare të auditit të brendshëm nga Center of Excellence in Finance (CEF).